



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“RROBAQEPËSI”

Niveli III në KSHK¹, referuar niveli III të KEK²

D5-III-26

Tiranë, 2026

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimiit	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	6
NjN-04-III-0574-26 Estetika e veshjes	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-04-III-0575-26 Planifikimi dhe organizimi i punës në rrobaqepësi.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-04-III-0576-26 Mjetet, pajisjet e punës dhe përdorimi i tyre në rrobaqepësi.....	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-04-III-0577-26 Materialet tekstile	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-04-III-0578-26 Vizatimi i modeleve të thjeshta.....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-04-III-0579-26 Bazat e prerjes.....	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-04-III-0580-26 Bazat e qepjes	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-04-III-0581-26 Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për gra	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehje	18

Kriteret e vlerësimit	18
NjN-04-III-0582-26 Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për burra	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	20
NjN-04-III-0583-26 Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për fëmijë	20
Rezultatet e të nxënit në njohuri	20
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	20
Kriteret e vlerësimit	21
NjN-04-III-0584-26 Aksesorët dhe dekorimi i veshjeve	21
Rezultatet e të nxënit në njohuri	21
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	21
Kriteret e vlerësimit	22
NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	22
Rezultatet e të nxënit në njohuri	22
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	23
Kriteret e vlerësimit	23
NjN-04-III-0585-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në rrobaqepësi	24
Rezultatet e të nxënit në njohuri	25
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	25
Kriteret e vlerësimit	26
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse.....	26
Modalitetet e vlerësimit	27
Informacion shtesë	27
SHËNIM	28

Emërtimi i kualifikimit	RROBAQEPËSI			Kodi
Kohëzgjatja	3300-4500 orë nacionale	Niveli	Niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK	D5-III-26
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Rrobaqepësi” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar në fushën e rrobaqepësisë, të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e rrobaqepësisë dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të sektorëve të prodhimit në rrobaqepësi të kësaj fushe apo për krijimin e menaxhimit të një biznesi privat, person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Rrobaqepësi” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë mbaruar arsimin bazë; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Pas përfundimit me sukses të kualifikimit profesional “Rrobaqepësi”, niveli III në KSHK, me kohëzgjatje 3 vite shkollore, pas përfundimit të arsimit bazë, individit pajiset me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale dhe suplementin përkatës dhe del në tregun e punës si punonjës i kualifikuar. Ky kualifikim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për punësim si rrobaqepës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve për burra, gra dhe fëmijë, njësi të qepjes dhe riparimit të tekstileve për përdorim shtëpiak, në dyqane të ndryshme artizanale, atelie mode apo të vetëpunësohet. Gjithashtu, përfundimi i këtij niveli lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në nivelin IV në KSHK, arsim profesional njëvjeçar (nivel teknik/menaxherial), me qëllim përfitimin e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” ose në kursin urë, të përgjithshëm dhe pas përfundimit të njërës nga këto kualifikime mund të vazhdojë studime pas të mesme ose universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	D1-III-26			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Rrobaqepësi**”, **niveli III në KSHK**, referuar nivelit III të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegëve dhe punonjësve në njësinë e tij/saj prodhuese;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të ndërmarrë apo hedhë vazhdimisht ide të reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese;
5. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
6. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
7. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
8. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj, të jetë i/e matur dhe i/e sjellshëm/me me eprorët, vartësit, partnerët, etj.;
9. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
10. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
11. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij/saj, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
12. Të jetë i/e hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partnerët, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese;
13. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
14. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
15. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtaritë shkollore dhe në

komunitet;

16. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
17. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
18. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
19. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
20. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
21. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-04-III-0574-26 Estetika e veshjes

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë estetikën e veshjes;
2. Të përshkruajë kodin e veshjes;
3. Të shpjegojë karakteristikat estetike të veshjes për grupmosha të caktuara;
4. Të rendisë funksionin estetik dhe praktik të veshjeve;
5. Të shpjegojë ndikimin e modës dhe estetikës në veshje;
6. Të përshkruajë individualitetet, risitë dhe tendencat në modë;
7. Të përshkruajë zhvillimin historik të veshjeve në periudha të ndryshme historike;
8. Të përshkruajë linjat kryesore të veshjeve, “A”, “H”, “T”, “I”, “V”, “X”, “Y”, linja trapez, linja trekëndësh, linja këmbanë, linja amforë, linja tullumbace, linja princeshë, linja asimetrike, linja sirenë etj.;
9. Të përshkruajë llojet e ndryshme të veshjeve sipas stileve (sportive, klasike, të përditshme, mbrëmjesh, pune, etj.);
10. Të përshkruajë karakteristikat e veshjeve popullore;
11. Të shpjegojë rëndësinë e ngjyrave në fushën e modës;
12. Të listojë ngjyrat e para, të dyta dhe të treta;
13. Të përshkruajë ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta;
14. Të përshkruajë kombinimet dhe kontrastin e ngjyrave;
15. Të përshkruajë përshtatjen e ngjyrave në veshje sipas stinës;
16. Të përshkruajë ndikimin vizual dhe psikologjik të ngjyrave në veshje.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të dallojë elementët estetikë të veshjes;
2. Të zbatojë kodin e veshjes sipas rastit dhe përdorimit;
3. Të përzgjedhë veshje sipas grupmoshës, stilit dhe funksionit të tyre;
4. Të dallojë stilet, linjat dhe format kryesore të veshjeve;

5. Të përdorë elementë të modës dhe tendencave në përzgjedhjen e veshjeve;
6. Të dallojë karakteristikat e veshjeve popullore;
7. Të përdorë kombinimet dhe kontrastet e ngjyrave në veshje;
8. Të përzgjedhë ngjyrat sipas stinës, stilit dhe funksionit të veshjes;
9. Të zbatojë përshtatjen estetike të ngjyrave në realizimin e veshjeve.

Kriteret e vlerësimit

- Dallon elementët estetikë të veshjes, sipas stilit të veshjes;
- Zbaton kodin e veshjes, sipas rastit dhe përdorimit;
- Përzgjedh veshje, sipas grupmoshës dhe karakteristikave estetike;
- Dallon funksionin estetik dhe praktik, sipas veshjes;
- Identifikon ndikimin e modës dhe estetikës sipas stilit të veshjes;
- Dallon risitë dhe tendencat kryesore në modë;
- Identifikon karakteristikat e veshjeve, sipas periudhave historike;
- Dallon linjat kryesore të veshjeve, sipas formave trupore;
- Identifikon stilet kryesore të veshjeve, sipas përdorimit;
- Dallon karakteristikat e veshjeve popullore, sipas krahinave;
- Zbaton përdorimin e ngjyrave në kombinimin e veshjeve, sipas stilit;
- Dallon ngjyrat e para, të dyta dhe të treta;
- Dallon ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta;
- Zbaton kombinimet dhe kontrastet e ngjyrave në veshje, sipas modelit;
- Përzgjedh ngjyrat, sipas stinës dhe llojit të veshjes;
- Identifikon ndikimin vizual dhe psikologjik të ngjyrave në veshje.

NjN-04-III-0575-26 Planifikimi dhe organizimi i punës në rrobaqepësi

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të punës në një industri/atelie;
2. Të përshkruajë strukturën organizative të një industrie/atelie;
3. Të shpjegojë proceset e punës dhe kohën e realizimit të tyre;
4. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të veprimtarisë ditore, javore dhe mujore;
5. Të shpjegojë rëndësinë e radhës së punës në rrobaqepësi;
6. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
7. Të shpjegojë rëndësinë e mënyrave dhe mjetet e pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;
8. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të materialeve;
9. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve dhe pajisjeve;
10. Të shpjegojë parimet, format dhe rëndësinë e bashkëpunimit me specialistë të tjerë;
11. Të argumentojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip;
12. Të analizojë mënyrat e dokumentimit dhe raportimit të punës së kryer;
13. Të shpjegojë rëndësinë dhe elementët e një plani pune;

14. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të veprimtarisë në rrobaqepësi, të burimeve, mjeteve të nevojshme, si dhe nevojave për staf.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë punën në një industri/atelie;
2. Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
3. Të planifikojë veprimtaritë ditore, javore dhe mujore;
4. Të bashkëpunojë me kolegë/specialistë të tjerë;
5. Të planifikojë burimet njerëzore;
6. Të përcaktojë radhën dhe kohën e punës në varësi të realizimit të produktit;
7. Të ndajë detyrat në ekip sipas proceseve;
8. Të kryejë pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve përkatëse;
9. Të dokumentojë dhe raportojë për punën e kryer.

Kriteret e vlerësimit

- Organizon punën në një industri/atelie, sipas kërkesës;
- Planifikon strukturën organizative në një industri/atelie;
- Përcakton proceset e punës dhe kohën e realizimit të tyre, sipas produktit;
- Planifikon radhën dhe kohën e punës, sipas proceseve;
- Planifikon veprimtaritë ditore, javore dhe mujore, sipas nevojës dhe rregullores së brendshme;
- Kryen pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, sipas praktikave standarde;
- Planifikon mjetet, veglat dhe pajisjet, sipas proceseve të punës;
- Përzgjedh mjetet, veglat dhe pajisjet, sipas proceseve të punës;
- Planifikon organizimin e materialeve, sipas proceseve të punës;
- Kontrollon funksionalitetin e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive, sipas manualeve përkatëse;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të shpjegojë parimet, format dhe rëndësinë e bashkëpunimit me specialistë të tjerë;
- Bashkëpunon me kolegë/specialistë të tjerë, sipas rregullores së brendshme;
- Ndan detyrat në ekip, sipas proceseve;
- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme, sipas proceseve të punës;
- Përzgjedh burimet njerëzore të nevojshme, sipas proceseve të punës dhe kualifikimeve përkatëse;
- Dokumenton kryerjen e punimeve, sipas formateve;
- Raporton për ecurinë e punës, sipas rregullores.

NjN-04-III-0576-26 Mjetet, pajisjet e punës dhe përdorimi i tyre në rrobaqepësi

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e mjeteve dhe pajisjeve të punës të përdorura në rrobaqepësi,
2. Të dallojë pajisjet manuale, makineritë dhe pajisjet ndihmëse;
3. Të identifikojë mjetet bazë të punës (gjilpëra, penj, gishtëza, gjilpëra me kokë, jastëk për gjilpëra, metër, mjete shënimi, mjete prerëse etj.) dhe funksionin e tyre.

4. Të shpjegojë përdorimin e mjeteve të qepjes me dorë dhe rëndësinë e përzgjedhjes së tyre sipas materialit;
5. Të shpjegojë funksionin dhe pjesët kryesore të makinës qepëse lineare dhe përdorimin e saj;
6. Të përshkruajë proceset përgatitore të makinave qepëse për punë (vendosja e penjve, vendosja e masurit, ndërrimi i gjilpërës etj.);
7. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e makinës syzator për përpunimin e skajeve të pëlhurës dhe qepjen e saj;
8. Të përshkruajë ndryshimet ndërmjet makinës qepëse lineare dhe makinës syzator;
9. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e makinave qepëse, të birave, të kopsave, dygjilpërësh, të filetove, përçinave etj.;
10. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e pajisjeve dhe makinerive të hekurosjes (hekuri, tavolina e hekurosjes, pajisje me avull);
11. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e tavolinave dhe mjeteve për shtrimin e tekstilit;
12. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e makinerive dhe mjeteve prerëse;
13. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e makinave të tezgjahut;
14. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e makinave të trikotazhit;
15. Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e makinave të qëndisjes;
16. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të sigurt të mjeteve dhe pajisjeve në vendin e punës;
17. Të shpjegojë rëndësinë e mirëmbajtjes, pastrimit, sistemimit dhe kontrollit të mjeteve dhe pajisjeve;
18. Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve dhe teknologjive digjitale në rrobaqepësi dhe rëndësinë e tyre në përmirësimin e punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë mjetet, pajisjet dhe makineritë e rrobaqepësisë;
2. Të përgatitë makinat qepëse sipas procedurave teknike të punës;
3. Të përdorë makinat qepëse sipas procedurave teknike të punës;
4. Të përdorë mjetet e shtrimit, prerjes, qepjes dhe hekurosjes sipas llojit të materialit;
5. Të përdorë makinat speciale të qepjes sipas procesit teknologjik;
6. Të zbatojë rregullat e sigurisë, mirëmbajtjes dhe organizimit të vendit të punës gjatë proceseve të punës;
7. Të përdorë pajisje dhe teknologji digjitale bazë në procesin e rrobaqepësisë.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh mjetet dhe pajisjet e rrobaqepësisë, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Dallon pajisjet manuale dhe pajisjet ndihmëse, sipas rolit në procesin e punës;
- Identifikon mjetet bazë të punës dhe funksionin e tyre, sipas proceseve të punës;
- Përzgjedh mjetet e qepjes me dorë, sipas llojit të materialit;
- Identifikon pjesët kryesore dhe përdorimin e makinës qepëse lineare sipas llojit;
- Përgatit makinën qepëse për punë, sipas procedurës teknike;
- Përdor makinën syzator për përpunimin e skajeve të tekstilit;
- Krahason makinën qepëse lineare me makinën syzator, sipas funksionit dhe përdorimit teknik;

- Rendit makinat speciale të qepjes, sipas funksionit të tyre teknik;
- Përdor makinën e nevertit, sipas procesit teknik të qepjes;
- Përdor makinën e birave dhe kopsave, sipas funksionit teknik;
- Përdor pajisjet dhe makineritë e hekurosjes, sipas karakteristikave të materialit;
- Përdor tavolinat dhe mjetet e shtrimit, sipas drejtimit të tekstilit;
- Përdor makineritë dhe mjetet prerëse duke respektuar kërkesat teknike dhe rregullat e sigurisë;
- Zbaton udhëzimet e manualeve teknike gjatë përgatitjes së makinerive dhe mjeteve ndihmëse për punë;
- Zbaton rregullat e sigurisë gjatë përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve në proceset e punës;
- Kryen mirëmbajtjen, pastrimin dhe sistemimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas praktikave standarde;
- Përdor pajisje dhe teknologji digjitale bazë, sipas manualit.

NjN-04-III-0577-26 Materialet tekstile

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë konceptin e fibrave tekstile dhe klasifikimin e tyre (natyrore, artificiale, sintetike);
2. Të përshkruajë vetitë kryesore të fibrave tekstile;
3. Të shpjegojë konceptin e fillit dhe mënyrat bazë të prodhimit të tij;
4. Të përshkruajë vetitë kryesore të fillit;
5. Të shpjegojë sistemin e numrit të fillit dhe rëndësinë e tij në përzgjedhjen për qepje;
6. Të shpjegojë konceptin e pëlhurës dhe mënyrat kryesore të prodhimit të tyre;
7. Të përshkruajë anën e përparme dhe anën e pasme të pëlhurës;
8. Të përshkruajë defektet e zakonshme të pëlhurave;
9. Të klasifikojë llojet kryesore të pëlhurave (të endura, të thurura dhe pa thurje);
10. Të përshkruajë strukturat bazë të pëlhurave të endura (garniturë, sarzhë, saten);
11. Të përshkruajë strukturat bazë të pëlhurave trikotazh (të bazës dhe të indit);
12. Të llogarisë koeficientin e elasticitetit dhe të rikthimit të një pëlhure;
13. Të shpjegojë drejtimin e fijes dhe rëndësinë e tij në prerje dhe qepje;
14. Të përshkruajë llojet kryesore të pëlhurave të endura dhe të thurura;
15. Të identifikojë në mënyrë organoleptike fibrat në një pëlhurë;
16. Të shpjegojë llojet e materialeve për realizimin e qëndisjes;
17. Të shpjegojë konceptin e materialeve ndërmjetëse në rrobaqepësi;
18. Të përshkruajë llojet kryesore të përforcuesve;
19. Të përshkruajë vetitë dhe funksionet e përforcuesve;
20. Të përshkruajë llojet kryesore të lëkurës (natyrore dhe artificiale);
21. Të identifikojë vetitë dhe përdorimin e lëkurës në veshje dhe aksesore;
22. Të shpjegojë karakteristikat bazë të gëzofëve dhe përdorimin e tyre;
23. Të përshkruajë llojet kryesore të mbërtheckave dhe zinxhirëve;
24. Të përshkruajë funksionin dhe karakteristikat e mbërtheckave dhe zinxhirëve;
25. Të shpjegojë rëndësinë e etiketimit të materialeve tekstile.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të dallojë materialet tekstile të përdorura në veshje;
2. Të dallojë fibrat tekstile sipas origjinës së tyre;
3. Të dallojë llojet e fillit sipas përdorimit të tyre;
4. Të identifikojë llojet kryesore të pëlhurave;
5. Të përzgjedhë pëlhurat dhe fijet sipas llojit të veshjes;
6. Të dallojë anën e përparme dhe anën e pasme të pëlhurës;
7. Të përcaktojë drejtimin e fijes në pëlhurë;
8. Të identifikojë defektet e zakonshme të pëlhurave;
9. Të përzgjedhë materialet ndërmjetëse dhe përforcuesit;
10. Të dallojë lëkurën dhe gëzofin natyral nga ai sintetik;
11. Të përzgjedhë mbërtheckat dhe zinxhirët sipas modelit të veshjes;
12. Të zbatojë informacionin e etiketimit të materialeve tekstile.

Kriteret e vlerësimit

- Klasifikon fibrat tekstile, sipas origjinës;
- Dallon vetitë kryesore të fibrave tekstile, sipas karakteristikave të tyre;
- Identifikon llojet e fillit sipas mënyrave të prodhimit të tij;
- Përcakton vetitë kryesore të fillit, sipas përdorimit të tyre;
- Përzgjedh penjtë sipas numrit për përdorim në qepje;
- Dallon llojet e pëlhurave, sipas mënyrës së prodhimit të tyre;
- Identifikon anën e përparme dhe anën e pasme të pëlhurës, sipas ndërtimit të tekstilit;
- Identifikon defektet e zakonshme në pëlhura, sipas teksturës së tekstilit;
- Dallon pëlhurat e endura, të thurura dhe pa thurje, sipas strukturës dhe përdorimit;
- Identifikon strukturat bazë të pëlhurave të endura, sipas prodhimit të tyre;
- Identifikon strukturat bazë të pëlhurave trikotazh, llojit të thurjes;
- Llogarit koeficientin e elasticitetit dhe rikthimit të pëlhurës, sipas metodës përkatëse;
- Përcakton drejtimin e fijes, sipas kërkesave të prerjes dhe qepjes;
- Dallon llojet kryesore të pëlhurave të endura dhe të thurura, sipas mënyrës së prodhimit të tyre;
- Identifikon fibrat në pëlhurë në mënyrë organoleptike;
- Përzgjedh materialet për qëndisje, sipas teknikës dhe llojit të punimit;
- Dallon materialet ndërmjetëse, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Identifikon llojet kryesore të përforcuesve, sipas strukturës dhe përdorimit;
- Përcakton vetitë dhe funksionet e përforcuesve në realizimin e veshjes, sipas llojit të përforcuesve;
- Dallon llojet kryesore të lëkurës, sipas karakteristikave dhe përdorimit;
- Identifikon vetitë dhe përdorimin e lëkurës në veshje dhe aksesorë, sipas llojit të lëkurës;
- Dallon karakteristikat dhe përdorimin e gëzofëve në veshje, sipas llojit të gëzofëve ;
- Identifikon llojet kryesore të mbërtheckave dhe zinxhirëve, sipas modelit përkatës;
- Përcakton funksionin dhe përdorimin e mbërtheckave dhe zinxhirëve, sipas veshjes;
- Interpretin informacionin e etiketimit të materialeve tekstile, sipas përmbajtjes.

NjN-04-III-0578-26 Vizatimi i modeleve të thjeshta

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e skicimit në forma të thjeshta gjeometrike;
2. Të shpjegojë strukturën dhe proporcionet bazë të trupit të njeriut;
3. Të identifikojë pozicionet (pozat) bazë të figurinës;
4. Të përshkruajë stilin figurativ në vizatimin e modës;
5. Të shpjegojë konceptin e vendosjes së veshjes në figurinë;
6. Të përshkruajë proporcionet e veshjes mbi figurë;
7. Të përshkruajë llojet bazë të veshjeve dhe pjesët përbërëse të tyre;
8. Të shpjegojë siluetat dhe format e veshjeve;
9. Të përshkruajë vijat kryesore të modelit;
10. Të përshkruajë elementet bazë të veshjeve në vizatim;
11. Të përshkruajë paraqitjen grafike të detajeve në skicë;
12. Të përshkruajë teknikat e paraqitjes së vizatimit bardh e zi;
13. Të shpjegojë teknikat e ngjyrave dhe rolin e tyre në paraqitjen e modelit;
14. Të shpjegojë mënyrat bazë të skicimit të aksesorëve.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të realizojë skicime në forma të thjeshta gjeometrike;
2. Të vizatojë figurinën sipas përmasave dhe proporcioneve bazë;
3. Të realizojë poza bazë të figurinës në vizatim;
4. Të vendosë veshjen mbi figurinë sipas proporcioneve përkatëse;
5. Të vizatojë silueta, forma dhe elemente bazë të veshjeve;
6. Të paraqesë grafikisht detajet e modelit në skicë;
7. Të përdorë teknikat bazë të vizatimit bardh e zi dhe ngjyrave;
8. Të realizojë skicime të aksesorëve bazë;
9. Të zbatojë elemente të stilit dhe historisë së modës në vizatim.

Kriteret e vlerësimit

- Realizon skicime me forma të thjeshta gjeometrike, sipas teknikave përkatëse;
- Vizaton figurinën sipas proporcioneve bazë të trupit të njeriut;
- Realizon pozat bazë të figurinës në mënyrë të saktë;
- Vendos veshjen mbi figurinë, sipas përmasave dhe proporcioneve;
- Dallon dhe paraqet siluetat dhe format bazë të veshjeve, sipas modelit;
- Vizaton pjesët dhe elementet bazë të veshjeve në skicë, sipas teknikave përkatëse;
- Realizon vijat kryesore të modelit në vizatim, sipas linjave udhëheqëse që përcaktojnë formën e veshjes;
- Realizon detajet e modelit në mënyrë grafike dhe të qartë;
- Përdor teknikat bazë të vizatimit bardh e zi në paraqitjen e modelit;
- Përdor ngjyrat sipas teknikave bazë të paraqitjes së modelit;
- Realizon skicime të aksesorëve bazë, sipas formës dhe funksionit.

NjN-04-III-0579-26 Bazat e prerjes

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të evidentojë pikat antropometrike të trupit;

2. Të përshkruajë mënyrën e marrjes së masave në trupin e njeriut;
3. Të evidentojë llojet e tabelave të përmasave dhe strukturën e tyre;
4. Të interpretojë të dhënat në tabelat e përmasave;
5. Të përshkruajë rëndësinë e koeficientit të lirshmërisë në veshje;
6. Të përshkruajë rëndësinë e ndërtimit saktë të kallëpit bazë;
7. Të shpjegojë teknikat e zhvillimit të modeleve të veshjeve;
8. Të përshkruajë teknikat dhe rëndësinë e vendosjes së shenjave orientuese;
9. Të shpjegojë teknikat e prerjes;
10. Të përshkruajë mënyrat e llogaritjes së sasisë së nevojshme të materialeve për ndërtimin e kallëpeve;
11. Të përshkruajë llojet e pencave dhe funksionet e tyre;
12. Të shpjegojë teknikat e manipulimit të pencave;
13. Të përshkruajë llojet e mostrave, supanjave dhe teknikat e prerjeve të tyre;
14. Të përshkruajë llojet e palave dhe rrudhave;
15. Të përshkruajë llojet e qemerëve dhe teknikat e prerjes së tyre;
16. Të përshkruajë llojet xhепave dhe teknikat e prerjes së tyre;
17. Të përshkruajë llojet mëngëve dhe teknikat e prerjes së tyre;
18. Të përshkruajë llojet dorezave dhe teknikat e prerjes së tyre;
19. Të përshkruajë llojet jakave dhe teknikat e prerjes së tyre;
20. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të bustit për gra dhe burra;
21. Të përshkruajë llojet e korseve të bustit dhe teknikat e prerjes së tyre;
22. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të fundit;
23. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të fustanit;
24. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të këmishëve për gra dhe burra;
25. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të pantallonit për gra dhe burra;
26. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të fund-pantallonit;
27. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të veshjeve të sipërme (jelek, xhaketa, pallto, pardesy) për gra dhe burra;
28. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të veshjeve sportive për gra dhe burra;
29. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të veshjeve të brendshme për gra dhe burra;
30. Të përshkruajë ndërtimin e kallëpit të veshjeve për fëmijë sipas grupmoshave (badi për bebe, tutina për bebe, kominoshe, bluzë, këmishë, fustan, pantallona);
31. Të përshkruajë teknikat e kontrollit të saktësisë së kallëpeve;
32. Të rendisë defektet në trupin e njeriut;
33. Të përshkruajë teknikat e korrigjimit të kallëpeve në përshtatje të defekteve trupore;
34. Të klasifikojë llojet bazë të manekineve;
35. Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së pëlhurës për tu përdorur në teknikën mulazh;
36. Të përshkruajë mënyrat e prerjes së tekstileve;
37. Të përshkruajë rëndësinë e ekonomizimit të tekstilit;
38. Të përshkruajë rëndësinë e drejtimit të pëlhurës në funksion të produktit;
39. Të rendisë mënyrat e palosjes së tekstilit;
40. Të përshkruajë mënyrat e vendosjes së pëlhurës mbi tavolinën e prerjes;
41. Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes dhe fiksimit të kallëpit mbi tekstile;
42. Të përcaktojë tolerancat për qepje në pjesë të ndryshme të veshjes;
43. Të përshkruajë llojet e shenjave, simboleve referuese në rrobaqepësi dhe teknikat e transferimit të shenjave nga kallëpi në tekstil;

44. Të përshkruajë teknikat për prerjen e tekstilit sipas kallëpit;
45. Të përshkruajë mënyrat e përdorimit të teknikave digjitale të ndërtimit të kallëpeve.

Rezultatet e të nxëniet në shprehi profesionale

1. Të përcaktojë pikat antropometrike dhe të kryejë marrjen e masave në trupin e njeriut;
2. Të përdorë tabela përmasash dhe koeficientët e lirshmërisë në ndërtimin e kallëpeve;
3. Të ndërtojë kallëpe bazë të veshjeve;
4. Të zhvillojë modele të ndryshme veshjesh;
5. Të vendosë shenjat orientuese në kallëp;
6. Të realizojë penca dhe manipulimin e tyre;
7. Të realizojë mostra, supanja, pala, plise, rrudha dhe qemerë në kallëpe;
8. Të ndërtojë xhepa, jaka dhe doreza të ndryshme;
9. Të ndërtojë kallëpe për veshje bazë për gra;
10. Të ndërtojë kallëpe për veshje bazë për burra;
11. Të ndërtojë kallëpe për veshje bazë për fëmijë;
12. Të ndërtojë kallëpe për veshje të sipërme dhe veshje sportive;
13. Të ndërtojë kallëpe për veshje të brendshme;
14. Të evidentojë dhe korrigjojë parregullsitë në kallëpe;
15. Të përdorë manekinët gjatë ndërtimit të kallëpeve;
16. Të përdorë teknikën e mulazhit në ndërtimin e kallëpeve;
17. Të përgatisë tekstilin për prerje;
18. Të realizojë palosjen dhe vendosjen e tekstilit në tavolinën e prerjes;
19. Të vendosë dhe fiksojë kallëpet mbi tekstil;
20. Të përcaktojë tolerancat për qepje në pjesë të ndryshme të veshjes;
21. Të transferojë shenjat dhe simbolet referuese nga kallëpi në tekstil;
22. Të kryejë prerjen e tekstilit sipas kallëpit;
23. Të ekonomizojë tekstilin gjatë vendosjes së kallëpeve;
24. Të përdorë teknika digjitale për ndërtimin e kallëpeve.

Kriteret e vlerësimit

- Përcakton pikat antropometrike të trupit, sipas procedurës së marrjes së masave;
- Kryen marrjen masave në trupin e njeriut, sipas teknikave të ndryshme të marrjes së masave;
- Përdor tabela të ndryshme të përmasave duke i përshtatur ato me trupin e njeriut;
- Përcakton koeficientin e lirshmërisë në veshje, në varësi të llojit të veshjes dhe materialit;
- Kryen ndërtimin e kallëpit, sipas teknikës së prerjes;
- Zhvillon modele të veshjeve duke përdorur kallëpin bazë;
- Vendos në kallëp shenjat orientuese, sipas mënyrës së pozicionimit dhe prerjes së pjesëve të kallëpit të veshjes;
- Përdor teknika të ndryshme të prerjes, në varësi të modelit të veshjes;
- Llogarit sasinë e nevojshme të materialeve për ndërtimin e kallëpeve, sipas llojit të veshjes;
- Ndërton lloje të ndryshme të pencave duke e përshtatur me modelin dhe funksionin që do kryejë në veshje;

- Kryen manipulimin e pencave, sipas modelit të veshjes;
- Ndërton lloje të ndryshme të mostrave dhe supanjave, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton lloje të ndryshme të palave dhe rrudhave, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton lloje të ndryshme të qemerëve, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton lloje të ndryshme të xhepave, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton lloje të ndryshme të dorezave, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton lloje të ndryshme të jakave, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton kallëpe të veshjeve të ndryshme për gra (funde, busti, këmisha, korse të bustit, fustane, pantallona, fund-pantallona) sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton kallëpe të veshjeve të ndryshme për burra (busti, këmisha, pantallona) sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton kallëpet e veshjeve të sipërme (jelek, xhaketa, pallto, pardesy) për gra dhe burra, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton kallëpet e veshjeve sportive për gra dhe burra, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton kallëpin e veshjeve të brendshme për gra dhe burra, sipas teknikave të prerjes;
- Ndërton kallëpin e veshjeve për fëmijë, sipas grupmoshave (badi për bebe, tutina për bebe, kominoshe, bluzë, këmishë, fustan, pantallona);
- Kryen kontrollin e saktësisë së kallëpit me anën e teknikave manuale dhe digjitale;
- Dallon defektet në kallëpet e veshjeve, sipas veçorive trupore;
- Korrigjon kallëpin në përshtatje të defekteve trupore;
- Përdor llojet bazë të manekinëve në varësi të masës trupore;
- Përgatit pëlhurën për tu përdorur në teknikën mulazh, në varësi të modelit të veshjes;
- Kryen prerjen e tekstit, sipas simboleve të vendosura në kallëp;
- Ekonomizon tekstin duke pozicionuar sa me afër kallëpet në tekstil;
- Pozicionon pëlhurën për vendosjen e kallëpeve, sipas modelit të veshjes;
- Palos tekstin në varësi të modelit të veshjes;
- Kryen vendosjen e pëlhurës mbi tavolinën e prerjes me metoda të ndryshme në varësi të llojit të tekstit dhe mënyrës së prodhimit;
- Vendos dhe fikson kallëpin mbi tekstil, sipas llojit të tekstit;
- Vendos tolerancat për qepje, sipas pjesëve të ndryshme të veshjes;
- Transferon nga kallëpi në tekstil llojet e shenjave, simboleve referuese, sipas teknikave të transferimit të shenjave;
- Pret tekstit, sipas formës së kallëpit;
- Ndërton kallëpet me teknika digjitale, sipas kërkesave teknike dhe përmasave.

NjN-04-III-0580-26 Bazat e qepjes

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet bazë të qepjes;
2. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të gishtzës në qepjet me dorë;
3. Të shpjegojë mënyrën e realizimit të nyjës së fijos;
4. Të identifikojë llojet bazë të qepjeve të përkohshme me dorë;
5. Të përshkruajë llojet bazë të qepjeve të përhershme me dorë;
6. Të përshkruajë llojet bazë të tegelave dhe përdorimin e tyre;
7. Të shpjegojë rëndësinë e tegelit në ndërtimin e veshjes;

8. Të shpjegojë rëndësinë e transferimit të shenjave në tekstil;
9. Të përshkruajë teknikat e përgatitjes së pjesëve për qepje;
10. Të shpjegojë teknikat e vendosjes së materialeve përforcuese;
11. Të shpjegojë teknikat e realizimit të pencave;
12. Të përshkruajë teknikat e realizimit të palave, pliseve dhe rrudhave në veshje;
13. Të shpjegojë teknikat bazë të bashkimit të pjesëve të veshjes;
14. Të përshkruajë teknikat e realizimit të filetove, xhepave, qemerëve dhe supanjave;
15. Të përshkruajë teknikat e qepjes së dekolteve;
16. Të shpjegojë teknikat e bashkimit të jakave, manshetave dhe mëngëve me veshjen;
17. Të përshkruajë teknikat e realizimit të mostrave dhe vendosjes së tyre në veshje;
18. Të përshkruajë teknikat e përgatitjes së astarëve dhe bashkimit të tyre me veshjen;
19. Të shpjegojë metodat e realizimit të mbylljeve dhe vendosjes së zinxhirëve;
20. Të shpjegojë mënyrat e përcaktimit të largësisë ndërmjet birave të kopsave;
21. Të përshkruajë teknikat e realizimit të birave të kopsave, qepjes së kopsave dhe elementeve të tjera mbërthyes;
22. Të shpjegojë teknikat e pastrimit përfundimtar të penjve në veshje;
23. Të shpjegojë rëndësinë e hekurosjes gjatë proceseve të qepjes;
24. Të shpjegojë teknikat e realizimit të prerjeve lehtësuese dhe heqjes së tepricës së tegelit;
25. Të shpjegojë teknikat e pastrimit dhe përfundimit të buzëve të tegelit;
26. Të përshkruajë teknikat e realizimit të kthimit të palës në veshje;
27. Të shpjegojë teknikat bazë të riparimit dhe modifikimit të veshjeve;
28. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e riciklimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë mjetet dhe pajisjet bazë të qepjes;
2. Të përdorë gishtëzën gjatë qepjeve me dorë;
3. Të realizojë nyjën e fijos;
4. Të realizojë qepje të përkohshme me dorë;
5. Të realizojë qepje të përhershme me dorë;
6. Të përdorë llojet bazë të tegelave sipas procesit të qepjes;
7. Të transferojë shenjat në tekstil;
8. Të përgatisë pjesët e veshjes për qepje;
9. Të vendosë materiale përforcuese në veshje;
10. Të realizojë penca;
11. Të realizojë pala, plise dhe rrudha në veshje;
12. Të bashkojë pjesët e veshjes;
13. Të realizojë fileto, xhepa, qemerë dhe supanja;
14. Të realizojë qepjen e dekolteve;
15. Të bashkojë jaka, mansheta dhe mëngë me veshjen;

16. Të realizojë mostra dhe të vendosë astarë në veshje;
17. Të realizojë mbyllje dhe të vendosë zinxhirë në veshje;
18. Të realizojë bira kopsash dhe të qepë kopsa e elemente të tjera mbërthyes;
19. Të kryejë hekurosjen gjatë proceseve të qepjes;
20. Të realizojë prerje lehtësuese dhe heqjen e tepricës së tegelit;
21. Të realizojë pastrimin dhe përfundimin e buzëve të tegelit;
22. Të realizojë kthimin e palës në veshje;
23. Të riparojë dhe modifikojë veshje;
24. Të riciklojë materiale për veshje.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor mjetet dhe pajisjet bazë të qepjes, sipas funksionit të tyre;
- Përdor gishtëzën gjatë qepjeve me dorë pa dëmtuar materialin dhe gishtat;
- Realizon nyjën e fijos në mënyrë të saktë;
- Realizon qepje të përkohshme me dorë, sipas procesit të punës;
- Realizon qepje të përhershme me dorë, sipas përdorimit të tyre;
- Përdor tegelat sipas llojit të materialit dhe procesit të qepjes;
- Realizon tegela të rregullta dhe të qëndrueshme në veshje;
- Transferon shenjat në tekstil pa deformuar materialin;
- Përcakton pozicionimin dhe largësinë ndërmjet birave të kopsave, sipas modelit;
- Përgatit pjesët e veshjes, sipas rendit teknologjik të qepjes;
- Vendos materialet përforcuese, sipas modelit dhe drejtimit të tekstilit;
- Realizon penca sipas vijave dhe përmasave të modelit;
- Realizon pala, plise dhe rrudha, sipas modelit të veshjes;
- Bashkon pjesët e veshjes, sipas rendit teknologjik të qepjes;
- Realizon fileto, xhepa, qemerë dhe supanja, sipas modelit;
- Realizon qepjen e dekolteve pa deformime;
- Bashkon jaka, mansheta dhe mëngë, sipas modelit teknik;
- Realizon mostra dhe i vendos në veshje, sipas kërkesave teknike;
- Përgatit dhe bashkon astarët me veshjen, sipas kërkesave teknike;
- Realizon mbylljet dhe vendos zinxhirët, sipas modelit dhe funksionit të tyre;
- Përcakton largësinë ndërmjet birave të kopsave në varësi të përmasave të kopsave dhe modelit të veshjes;
- Kryen hekurosjen, sipas llojit të materialit dhe procesit të qepjes;
- Realizon prerje lehtësuese dhe heqjen e tepricës së tegelit, sipas kërkesave teknike;
- Realizon pastrimin dhe përfundimin e buzëve të tegelit pa deformime;
- Realizon pastrimin e penjve të tepërt pa dëmtuar materialin;
- Realizon kthimin e palës me gjerësi uniforme;
- Realizon riparime dhe modifikime bazë të veshjeve, sipas kërkesës;
- Realizon veshje duke përdorur materiale të riciklueshme.

NjN-04-III-0581-26 Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për gra

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë karakteristikat teknike të veshjeve bazë për gra;
2. Të përshkruajë rendin teknologjik të qepjes së veshjeve bazë për gra;
3. Të shpjegojë teknikat e qepjes së fundeve;
4. Të shpjegojë teknikat e qepjes së pantallonave;
5. Të shpjegojë teknikat e qepjes së fund-pantallonave;
6. Të shpjegojë teknikat e qepjes së bluzave dhe këmishëve;
7. Të shpjegojë teknikat e qepjes së korsesë së bustit;
8. Të shpjegojë teknikat e qepjes së fustaneve;
9. Të shpjegojë teknikat e qepjes së veshjeve sportive për gra;
10. Të shpjegojë teknikat e qepjes së veshjeve të gjumit dhe veshjeve të brendshme;
11. Të shpjegojë teknikat e qepjes së jelekëve dhe xhaketave të lehta;
12. Të shpjegojë teknikat e qepjes së palltove;
13. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e provës së veshjes gjatë procesit të qepjes;
14. Të shpjegojë teknikat e korrigjimit të veshjes gjatë procesit të qepjes;
15. Të shpjegojë teknikat e vendosjes së etiketave në veshje;
16. Të shpjegojë teknikat e përfundimit dhe kontrollit të qepjes së veshjeve;
17. Të shpjegojë teknikat e paketimit të veshjeve për gra.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rendin teknologjik gjatë qepjes së veshjeve për gra;
2. Të qepë funde;
3. Të qepë pantallona;
4. Të qepë fund- pantallona;
5. Të qepë bluza dhe këmisha;
6. Të qepë fustane;
7. Të qepë veshje gjumi dhe veshje të brendshme;
8. Të qepë veshje sportive;
9. Të qepë jelekë dhe xhaketa të lehta;
10. Të qepë pallto;
11. Të kryejë provën dhe korrigjimin e veshjes gjatë procesit të qepjes;
12. Të kryejë përfundimin dhe kontrollin e veshjeve;
13. Të kryejë etiketimin dhe paketimin e veshjeve.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rendin teknologjik gjatë qepjes së veshjeve për gra;
- Qep funde sipas modelit, përmasave dhe kërkesave teknike;
- Qep pantallona, sipas kërkesave teknike;

- Qep fund- pantallona, sipas kërkesave teknike;
- Qep bluza dhe këmisha, sipas modelit dhe karakteristikave të materialit;
- Qep fustane, sipas modelit dhe kërkesave estetike;
- Qep veshjet sportive, sipas karakteristikave të materialit dhe modelit;
- Qep veshje gjumi dhe veshje të brendshme, sipas modelit dhe materialit;
- Qep jelekë dhe xhaketa të lehta sipas modelit;
- Qep pallto sipas modelit;
- Kryen provën e veshjes dhe evidenton korrigjimet e nevojshme gjatë procesit të qepjes;
- Kryen korrigjimet e veshjes, sipas rezultateve të provës;
- Kryen përfundimin e veshjes me pastërti dhe saktësi teknike;
- Kontrollon cilësinë e qepjes së veshjes, sipas kërkesave teknike dhe estetike;
- Identifikon dhe korrigjon parregullsitë gjatë qepjes së veshjes;
- Kryen etiketimin e veshjes, sipas kërkesave të procesit të punës;
- Kryen hekurosjen e veshjes, sipas llojit të materialit dhe kërkesave të procesit të punës;
- Kryen paketimin e veshjes, sipas kërkesave të paraqitjes dhe ruajtjes së saj.

NjN-04-III-0582-26 Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për burra

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë karakteristikat teknike të veshjeve bazë për burra;
2. Të përshkruajë rendin teknologjik të qepjes së veshjeve bazë për burra;
3. Të shpjegojë teknikat e qepjes së këmishëve;
4. Të shpjegojë teknikat e qepjes së pantallonave;
5. Të shpjegojë teknikat e qepjes së T-shirt dhe veshjeve sportive për burra;
6. Të shpjegojë teknikat e qepjes së jelekëve dhe xhaketave të lehta;
7. Të shpjegojë teknikat e qepjes së pardesyve;
8. Të shpjegojë teknikat e qepjes së veshjeve të gjumit dhe veshjeve të brendshme;
9. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e provës së veshjes gjatë procesit të qepjes;
10. Të shpjegojë teknikat e korrigjimit të veshjes gjatë procesit të qepjes;
11. Të shpjegojë teknikat e vendosjes së etiketave në veshje;
12. Të shpjegojë teknikat e përfundimit dhe kontrollit të qepjes së veshjeve;
13. Të shpjegojë teknikat e paketimit të veshjeve për burra.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rendin teknologjik gjatë qepjes së veshjeve për burra;
2. Të qepë këmisha;
3. Të qepë pantallona;
4. Të qepë T-shirt dhe veshje sportive;
5. Të qepë jelekë dhe xhaketa të lehta;
6. Të qepë pardesy;
7. Të qepë veshje gjumi dhe veshje të brendshme;

8. Të kryejë provën dhe korrigjimin e veshjes gjatë procesit të qepjes;
9. Të kryejë përfundimin dhe kontrollin e veshjeve;
10. Të kryejë etiketimin dhe paketimin e veshjeve.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rendin teknologjik gjatë qepjes së veshjeve për burra;
- Qep këmisha sipas modelit dhe kërkesave teknike;
- Qep pantallona sipas modelit dhe kërkesave teknike;
- Qep T-shirt dhe veshje sportive, sipas karakteristikave të materialit dhe modelit;
- Qep jelekë dhe xhaketa të lehta, sipas modelit teknik;
- Qep pardesy sipas modelit teknik;
- Qep veshje gjumi dhe veshje të brendshme, sipas karakteristikave funksionale të tyre;
- Kryen provën e veshjes dhe evidenton korrigjimet e nevojshme gjatë procesit të qepjes;
- Kryen korrigjimet e veshjes sipas rezultateve të provës;
- Kryen përfundimin e veshjes me pastërti dhe saktësi teknike;
- Kontrollon cilësinë e qepjes së veshjes, sipas kërkesave teknike dhe estetike;
- Identifikon dhe korrigjon parregullsitë gjatë qepjes së veshjes;
- Kryen etiketimin e veshjes, sipas kërkesave të procesit të punës;
- Kryen hekurosjen e veshjes, sipas kërkesave të procesit të punës dhe llojit të materialit;
- Kryen paketimin e veshjes, sipas kërkesave të paraqitjes dhe ruajtjes së saj.

NjN-04-III-0583-26 Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për fëmijë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë karakteristikat teknike të veshjeve bazë për fëmijë;
2. Të përshkruajë rendin teknologjik të qepjes së veshjeve bazë për fëmijë;
3. Të shpjegojë teknikat e qepjes së bluzave dhe këmishëve për fëmijë;
4. Të shpjegojë teknikat e qepjes së pantallonave, fundeve dhe pantallonave të shkurtra për fëmijë;
5. Të shpjegojë teknikat e qepjes së fustaneve dhe kominosheve për fëmijë;
6. Të shpjegojë teknikat e qepjes së veshjeve sportive dhe veshjeve të gjumit për fëmijë;
7. Të shpjegojë teknikat e vendosjes së etiketave në veshje;
8. Të shpjegojë teknikat e përfundimit dhe kontrollit të qepjes së veshjeve për fëmijë;
9. Të shpjegojë teknikat e paketimit të veshjeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rendin teknologjik gjatë qepjes së veshjeve për fëmijë;
2. Të qepë bluza dhe këmisha për fëmijë;
3. Të qepë pantallona, funde dhe pantallona të shkurtra për fëmijë;
4. Të qepë fustane dhe kominoshe për fëmijë;
5. Të qepë veshje sportive dhe veshje gjumi për fëmijë;

6. Të kryejë përfundimin dhe kontrollin e qepjes së veshjeve për fëmijë.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rendin teknologjik gjatë qepjes së veshjeve për fëmijë;
- Qep bluza dhe këmisha për fëmijë sipas modelit dhe kërkesave teknike;
- Qep pantallona, funde dhe pantallona të shkurtra për fëmijë, sipas modelit dhe përmasave;
- Qep fustane dhe kominoshe, sipas modelit dhe karakteristikave të materialit;
- Qep veshje sportive dhe veshje gjumi, sipas kërkesave funksionale të tyre;
- Kryen përfundimin e veshjes me pastërti dhe saktësi teknike;
- Kontrollon cilësinë e qepjes së veshjes, sipas kërkesave teknike dhe estetike;
- Identifikon dhe korrigjon parregullsitë gjatë qepjes së veshjes;
- Kryen etiketimin e veshjes, sipas kërkesave të procesit të punës;
- Kryen hekurosjen e veshjes, sipas kërkesave të procesit të punës dhe llojit të materialit;
- Kryen paketimin e veshjes, sipas kërkesave të të paraqitjes dhe ruajtjes së saj.

NjN-04-III-0584-26 Aksesorët dhe dekorimi i veshjeve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e dekorimit të veshjeve;
2. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të aksesorëve si element dekorues dhe funksional;
3. Të përshkruajë llojet e tegelave dekorues dhe përdorimin e tyre;
4. Të shpjegojë teknikat e realizimit të tegelave dekorues;
5. Të shpjegojë teknikat bazë të realizimit të qëndisjeve të thjeshta;
6. Të përshkruajë teknikat e përdorimit të rruazave, gurëve dhe materialeve të tjera dekorative;
7. Të përshkruajë teknikat e dekorimit me fileto, kordonë, zinxhirë, dantella, lule dekorative etj.;
8. Të përshkruajë teknikat e dekorimit me aplikacione dekorative;
9. Të përshkruajë procesin bazë të realizimit të aksesorëve dhe zbukurimeve dekorative;
10. Të përshkruajë procesin bazë të realizimit të çantave dhe rripave;
11. Të përshkruajë procesin bazë të realizimit të dorashkave;
12. Të përshkruajë procesin bazë të realizimit të kapeleve;
13. Të shpjegojë mënyrat e modifikimit dhe përshtatjes së veshjeve ekzistuese.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të realizojë tegela dekorues në veshje;
2. Të realizojë qëndisje të thjeshta dekorative;
3. Të përdorë rruaza, gurë dhe materiale dekorative në zbukurimin e veshjeve;
4. Të realizojë dekorime me fileto, kordonë, zinxhirë dhe dantella;
5. Të realizojë aplikacione dekorative në veshje;
6. Të realizojë aksesorë dhe zbukurime dekorative;
7. Të realizojë çanta, rripa, dorashka, kapele bazë;

8. Të modifikojë dhe përshtatë veshje ekzistuese.

Kriteret e vlerësimit

- Dallon funksionin estetik dhe dekorativ të zbukurimeve në veshje, sipas modelit;
- Përdor aksesoret si element funksional dhe dekorativ në veshje, sipas modelit;
- Realizon tegela dekorues, sipas modelit të përcaktuar;
- Zbaton teknikat bazë të tegelave dekorues gjatë punës (tegël i drejtë dekorativ, zig-zag, me fije zbukuruese etj.) ;
- Kryen qëndisje të thjeshta, sipas modelit dekorativ;
- Përdor rruaza, gurë dhe materiale dekorative, sipas efektit estetik të kërkuar;
- Realizon dekorime me fileto, kordonë, zinxhirë, lule dekorative dhe dantella, sipas modelit të përcaktuar;
- Realizon aplikacione dekorative, sipas modelit;
- Realizon aksesore dhe zbukurime dekorative, sipas formës dhe përmasave të kërkuara;
- Realizon çanta dhe rripa bazë, sipas modelit;
- Realizon aksesore dorashkat, sipas skicës së modelit;
- Realizon aksesore kapele, sipas skicës së modelit;
- Modifikon dhe përshtat veshje ekzistuese, sipas kërkesës.

NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të Kodit të Punës dhe legjislacionit përkatës që lidhet me aktivitetin profesional në rrobaqepësi;
2. Të përshkruajë mënyrat e përpilimit, përdorimit dhe ruajtjes së dokumentacionit profesional;
3. Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së ofertave dhe dokumenteve financiare në rrobaqepësi;
4. Të identifikojë elementët bazë të ofertës dhe faturës;
5. Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit dhe dokumentimit korrekt të të dhënave profesionale dhe financiare;
6. Të shpjegojë elementët e kostos dhe mënyrën e përlllogaritjes së çmimit të një produkti veshjeje;
7. Të identifikojë faktorët që ndikojnë në çmimin dhe fitimin e produktit;
8. Të shpjegojë rëndësinë e inventarit dhe menaxhimit të materialeve në rrobaqepësi;
9. Të përshkruajë procedurat e furnizimit dhe dokumentacionin përkatës;
10. Të shpjegojë mënyrat e përzgjedhjes së furnitorëve dhe informimit mbi çmimet dhe cilësinë e materialeve;
11. Të shpjegojë konceptin dhe rëndësinë e marketingut në rrobaqepësi;
12. Të përshkruajë mënyrat e promovimit të shërbimeve dhe rëndësinë e kënaqësisë së klientit;
13. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit dhe zhvillimit profesional;
14. Të përshkruajë zhvillimin e karrierës dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës;
15. Të identifikojë mënyrat e zhvillimit profesional dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
16. Të përshkruajë teknologjitë bashkëkohore të përdorura në rrobaqepësi;
17. Të shpjegojë rëndësinë e teknologjisë dhe inovacionit në përmirësimin e cilësisë dhe

efikasitetit të punës;

18. Të identifikojë mënyrat e zbatimit të teknikave dhe teknologjive të reja në profesion;
19. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit profesional dhe punës në ekip;
20. Të përshkruajë mënyrat e shkëmbimit të njohurive dhe përmirësimit profesional;
21. Të identifikojë mundësitë e zhvillimit profesional përmes trajnimeve, panairove dhe burimeve të informacionit profesional;
22. Të identifikojë mundësitë e punësimit dhe zhvillimit në sektorin e rrobaqepësisë;
23. Të përshkruajë konceptin e komunikimit dhe metodat kryesore të tij në një mjedis profesional;
24. Të shpjegojë parimet bazë të punës në grup dhe rëndësinë e bashkëpunimit në realizimin e detyrave;
25. Të dallojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
26. Të shpjegojë parimet e Kodit të Etikës dhe rëndësinë e zbatimit të tij në vendin e punës;
27. Të përshkruajë metodat bazë të zgjidhjes së problemeve dhe rolin e mendimit kritik në situata pune;
28. Të identifikojë bashkëpunëtorët kryesorë në veprimtarinë profesionale dhe rolin e secilit;
29. Të shpjegojë përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin profesional;
30. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit korrekt të terminologjisë profesionale në rrobaqepësi;
31. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së të dhënave konfidenciale dhe mbrojtjes së informacionit;
32. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit (gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.) në mjedisin e punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin e fushës dhe rregullat bazë të punës në aktivitetin profesional;
2. Të kryejë llogaritje të kostove, çmimeve dhe materialeve për punime në rrobaqepësi;
3. Të plotësojë dhe regjistrojë dokumente financiare dhe profesionale;
4. Të kryejë procedurat e furnizimit;
5. Të kryejë procedurat e inventarizimit;
6. Të përgatitë oferta për shërbime rrobaqepësie;
7. Të plotësojë dokumentet e dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve;
8. Të përdorë forma të promovimit të shërbimeve të rrobaqepësisë;
9. Të zbatojë metoda të vetëvlerësimit dhe zhvillimit profesional;
10. Të përdorë teknologjinë dhe burimet e informacionit për zhvillim profesional;
11. Të zbatojë etikën profesionale dhe komunikimin në vendin e punës;
12. Të bashkëpunojë/punojë në grup në mënyrë efektive;
13. Të përdorë komunikimin digjital dhe dokumentacionin profesional;
14. Të respektojë rregullat e konfidencialitetit dhe sigurisë së informacionit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton Kodin e Punës dhe legjislacionin në fushën e rrobaqepësisë;
- Plotëson kontrata pune ose shërbimi, sipas modelit të dhënë;

- Përgatit oferta dhe dokumente financiare për shërbime rrobaqepësie;
- Ruan dokumentacionin profesional, sipas rregullave të arkivimit;
- Identifikon elementët bazë të ofertës dhe faturës;
- Plotëson saktë dokumentacionin profesional dhe financiar;
- Llogarit koston dhe çmimin e një produkti veshjeje;
- Identifikon faktorët që ndikojnë në çmimin dhe fitimin e produktit;
- Regjistron dhe kontrollon inventarin e materialeve dhe pajisjeve;
- Ndjek procedurat e furnizimit dhe përdor dokumentacionin përkatës;
- Përzgjedh furnitorë dhe materiale, sipas çmimit dhe cilësisë;
- Identifikon mënyrat bazë të marketingut në rrobaqepësi;
- Përdor forma promovimi për shërbimet e rrobaqepësisë dhe komunikon me klientin;
- Përdor metoda vetëvlerësimi për zhvillim profesional;
- Identifikon aftësitë dhe kërkesat për zhvillim në tregun e punës;
- Përdor mënyra të zhvillimit profesional dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Identifikon teknologjitë bashkëkohore të përdorura në rrobaqepësi;
- Përdor teknologjinë dhe inovacionin për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të punës;
- Zbaton teknika dhe teknologji të reja në proceset e punës;
- Komunikon në mënyrë profesionale me bashkëpunëtorët gjatë proceseve të punës;
- Bashkëpunon me anëtarët e grupit gjatë realizimit të detyrave në rrobaqepësi;
- Shkëmben njohuri dhe përvoja profesionale me bashkëpunëtorët;
- Përdor burime informacioni dhe mundësi trajnimi për zhvillim profesional;
- Identifikon mundësitë e punësimit dhe zhvillimit në sektorin e rrobaqepësisë;
- Zbaton parimet e etikës profesionale;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal, jo verbal, shkresor, digjital;
- Përdor terminologji të përshtatshme profesionale, sipas kodit të etikës;
- Komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me klientët dhe kolegët;
- Komunikon me kolegët dhe bashkëpunëtorët duke përdorur terminologji bazë profesionale;
- Merr pjesë aktive në detyrë në grup;
- Ndjek me korrektësi udhëzimet dhe kontribuon në vendimmarrje;
- Zgjidh konflikte të thjeshta në mënyrë pozitive;
- Zbaton në mënyrë efektive teknikat e zgjidhjes së konflikteve dhe mendimit kritik;
- Përdor terminologji profesionale në komunikim digjital, sipas rregullit;
- Harton përshkrime pune të qarta, të strukturuar dhe me gjuhë profesionale, në përputhje me kërkesat e pozicionit;
- Zbaton rregullat për ruajtjen e informacionit konfidencial në punë (klientë, çmime, projekte), sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes (fjalëkalime, mosndarje pa leje, ruajtje dokumentesh etj.), sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas rregullit;
- Paraqet sjellje korrekte në situata të diskriminimit duke respektuar barazinë dhe respektin.

NjN-04-III-0585-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në rrobaqepësi

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
2. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të identifikojë rreziqet kryesore gjatë përdorimit të makinës qepëse, hekurit dhe pajisjeve të avullit, gjilpërave dhe mjeteve prerëse;
4. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të gjendjes teknike të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
5. Të shpjegojë rëndësinë e raportimit të defekteve apo mos funksionimeve të mjeteve dhe pajisjeve;
6. Të shpjegojë rëndësinë e qëndrimit korrekt gjatë punës në makinë qepëse;
7. Të identifikojë faktorët që ndikojnë në lodhje dhe dëmtime (pozicioni, ndriçimi, ritmi i punës, pluhurat etj.);
8. Të identifikojë procedurat dhe mjetet për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
9. Të interpretojë sinjalistikat dhe shenjat paralajmëruese në mjedisin e punës;
10. Të përshkruajë procedurat e evakuimit në raste emergjence;
11. Të shpjegojë përdorimin dhe funksionin e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri (MZSH³);
12. Të shpjegojë masat e sigurisë gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
13. Të shpjegojë konceptin dhe karakteristikat e zhvillimit të mjedisit të qëndrueshëm në rrobaqepësi;
14. Të përshkruajë mënyrat për menaxhimin e mbetjeve tekstile dhe ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
15. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve tekstile;
16. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së sigurt të mjeteve prerëse dhe pajisjeve;
17. Të përshkruajë rreziqet që lidhen me përdorimin e energjisë elektrike në vendin e punës;
18. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të kablllove, prizave dhe pajisjeve elektrike (makinë qepëse, hekur etj.);
19. Të përshkruajë rëndësinë e testimit të pajisjeve elektrike për funksionim të sigurt;
20. Të dallojë llojet e sinjalistikës për sigurinë teknike në vendin e punës;
21. Të shpjegojë protokollet e duhura të veprimit në raste të rrezikut apo situatave të jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe legjislacionin për sigurinë në punë;
2. Të zbatojë procedurat e ndihmës së parë dhe për emergjencat;
3. Të respektojë sinjalistikën dhe rregullat e sigurisë;
4. Të përdorë pajisjet e mbrojtjes dhe sigurisë nga zjarri (MZSH)
5. Të zbatojë procedurat gjatë punës me materiale dhe solucione me përmbajtje kimike;
6. Të kryejë raportim dhe mirëmbajtje të pajisjeve të sigurisë;
7. Të zbatojë procedurat për verifikimin e kablllove dhe pajisjeve elektrike;
8. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
9. Të zbatojë procedurat në situata emergjente.

³ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton standardet dhe aktet ligjore kryesore për sigurinë në punë, me korrektësi;
- Zbaton udhëzimet e manualeve, në mënyrë të saktë të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Zgjedh mjetet për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti, sipas procedurave;
- Zbaton saktë procedurat e dhënies së ndihmës së parë, sipas protokollit;
- Dallon saktë shenjat e sigurisë në mjedisin e punës;
- Reagon saktë në situata praktike sipas sinjalistikës;
- Përdor tabelat e kufizimit dhe sinjalistikën në mënyrë të përshtatshme;
- Zbaton saktë procedurat në raste evakuimi duke respektuar sinjalistikën;
- Përdor pajisjet kundër zjarrit në mënyrë të sigurt;
- Zbaton masat mbrojtëse gjatë përdorimit praktik të solucioneve me përmbajtje kimike, sipas llojit në mënyrë të saktë;
- Organizon materialet dhe solucionet, sipas standardeve të sigurisë;
- Zbaton procedurat për ndarje të saktë të mbetjeve;
- Zbaton rregulloret për kryerjen e depozitimit të mbetjeve, në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Zbaton procedurat e mbrojtjes së mjedisit, sipas standardit/rregullave përkatëse;
- Zbaton rregullat e përdorimit efikas të burimeve të lëndëve të para dhe atyre të energjisë;
- Zbaton udhëzimet teknike për ruajtjen dhe përdorimin e materialeve, referuar minimizimit të rrezikut për ndotjen e mjedisit;
- Dokumenton dhe ndjek procedurën e plotë të raportimit në rast mosfunksionimi të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Zgjedh dhe përdor pajisjet mbrojtëse personale të duhura;
- Kryen kontrollin vizual të pajisjeve të MZSH në mënyrë sistematike, duke identifikuar dhe raportuar dëmtimet ose defektet e mundshme;
- Përdor saktë pajisjet e MZSH-së;
- Përdor pajisjet për matje të thjeshta për kontrollin elektrik, sipas procedurave dhe rregullave të sigurisë;
- Zbaton masa parandaluese, në mënyrë të rregullt dhe të përshtatshme, në raste të mundshme dëmtimesh;
- Kryen teste bazë të pajisjeve elektrike, sipas udhëzimeve;
- Zbaton me korrektësi protokollet në gjendje të jashtë zakonshme;
- Reagon saktë dhe në kohë në simulime praktike të situatave të jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Estetika e veshjes	4	NjN-04-III-0574-26
2	Planifikimi dhe organizimi i punës në rrobapëpësi	2	NjN-04-III-0575-26
3	Mjetet, pajisjet e punës dhe përdorimi i tyre në rrobapëpësi	5	NjN-04-III-0576-26
4	Materialet tekstile	5	NjN-04-III-0577-26

5	Vizatimi i modeleve të thjeshta	4	NjN-04-III-0578-26
6	Bazat e prerjes	18	NjN-04-III-0579-26
7	Bazat e qepjes	19	NjN-04-III-0580-26
8	Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për gra	20	NjN-04-III-0581-26
9	Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për burra	11	NjN-04-III-0582-26
10	Teknikat e qepjes së veshjeve bazë për fëmijë	4	NjN-04-III-0583-26
11	Aksesorët dhe dekorimi i veshjeve	3	NjN-04-III-0584-26
12	Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	3	NjN-24-III-0492-26
13	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në rrobapqepësi	2	NjN-04-III-0585-26
	Totali	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individi i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- njohjes të të nxënit të përftuar jashtë vendit;
- formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **D5-III-26**

D – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

5 - Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

III – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK -së

26 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-04-III-0574-26**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

04 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

III – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK -së

0574 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

26 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit